

**DREJTORIA E PLANIFIKIMIT URBAN, LEJEVE DHE MONITORIMIT TE
INVESTIMEVE**

RELACION TEKNIK

“Rehabilitim i rruges Gaqi Gjika-Segmenti me kalldrem ”

BERAT

Grupi projektimit:

Ing.Rolinda Veliu

Ing.Valentina Karabina

Ing.Besjana Kokoshi

Ark.Frenci Ceca

Ing.Anxhelo Dhimo

Top. Dejani Zylyftari

1. QËLLIMI

Në mbështetje të detyrës së projektimit për objektin në fjalë, është hartuar projekti **“Rehabilitim i rrugës ‘Gaqi Gjika’”**, i cili shtrihet nga fundi i poliklinikës në lagjen **“28 Nëntori”** deri tek kthesa pranë urës, me një gjatësi totale rreth **500 ml**.

Ky projekt parashikon rehabilitimin e aksit rrugor ekzistues, i cili ndodhet në një zonë të banuar, shumë pranë qendrës së qytetit, dhe që shërben si lidhje funksionale ndërmjet lagjes dhe sheshit **“Iliaz Vrioni”**. Rruga mundëson aksesin e automjeteve dhe këmbësorëve drejt qendrës së qytetit.

Në gjendjen aktuale, rreth **100 ml** të këtij aksi janë të shtruara me **kalldrëm**, ndërsa pjesa tjetër është e shtruar me **asfalt**. Për shkak të amortizimit të infrastrukturës ekzistuese dhe nevojës për përmirësimin e kushteve të qarkullimit dhe të përdorimit të hapësirës publike, është i nevojshëm rehabilitimi i plotë i kësaj rruge.

Ndërhyrja synon përmirësimin e infrastrukturës rrugore, rritjen e cilësisë së jetesës së banorëve të zonës, si dhe rritjen e atraktivitetit të saj për vizitorët vendas dhe të huaj..

Aktualisht rruga ndjek një gjurmë ekzistuese në të gjithë gjatësinë e saj. Një pjesë e segmentit që parashikohet të rehabilitohet ndodhet brenda **zonës së mbrojtur tampon**, ndaj ndërhyrja do të trajtohet në përputhje me kushtet dhe kriteret specifike të përcaktuara për këto zona.

2. VËNDNDODHJA

Zona në të cilën do të kryhet investimi i rrugës Gaqi Gjika, fillon nga fundi i Poliklinikës deri tek perfundimi i kalldremit me gjatësi rreth 100 ml –do të rehabilitohet vetëm segmenti me kalldrem



Rruga shtrihet ne lagjja “10 korriku”, dy lagje qe kane shtrirje kodrinore . Te shprehur ne kordinata fillimi dhe perfundimi I rruges jepen si me poshte

Piketa	N	E
1	4507811.69	496248.84
2	4507873.29	496311.84

3.GJËNDJA EKZISTUESE

Segmenti rrugor i marre ne shqyrtim do te filloje nga fundi i poliklinikes deri tek perfundimit i kalldremit me nje gjatesi rreth 100 ml.

-Zona nga objekti i poliklinikes deri tek fillimi i asfaltit (nje pjese te rruges Gaqi Gjika) eshte e shtruar me kalldrem i cili eshte shume i amortizuar.

Kjo rruge me nje gjatesi gati 100 ml eshte nje funksionale
Nga ana e pershkrimit do ta ndajme ne dy zona.

Zona e pare pjese e rruges “Gaqi Gjika” nje rruge lagjeje qe lidhet me sheshin”Iliaz Vrioni” eshte e shtruar me kalldrem ne nje nivel te amortizuar, vende vende mungen shtresa e kalldremit.Ne kete rruge pershkak te nderhyrjeve qe jane bere nga ku kane levizur shtresat e siperme te kalldremit, rivendosja e tyre nuk eshte ne nje nivel te njetrajtshem duke sjell probleme jo vetem vizuale por edhe ne funksion.

4. RELIEVI TOPOGRAFIK

Rilevimi topografik i zones eshte hartuar bazuar ne azhornimet te Drejtorise dhe matjeve topografike te nevojshme ne terren .Ne planimetri jane dhene permasat e rruges ekzistuese kuotat e nivelit sipas piketave te dhena ne hartat e gjendjes ekzistuese.

5. PAMJE NGA GJENDJA EKZISTUEES



5. ZGJIDHJE TEKNIKE E PROJEKTIT

Sipas Planit të Përgjithshëm Vendor rruget **Rruha Gaqi Gjika në PPV** është rrugë e kategorisë **F ruge Lokale** me kod seksion prerje FB - NN me gjatësi të propozuar 6m.

Bazuar në detyrën e projektimit dhe në urdherin nr.287 datë 15.04.2025 grupi i projektimit do të hartojë projektin e zbatimit për rehabilitim të gjendjes ekzistuese.

Në segmentin e parë ku kemi aktualisht gjendjen me kalldrem do të bëhet prishje e shtresave ekzistuese, shtrese cakulli për rehabilitimin e trupti të rrugës, ngjeshje të saj, shtrese stabilizanti për nivelim, shtrese rere dhe shtresat e kalldremit.